



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**ADGJTHFR.nr.3/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese av. A.L. nga Prishtina, Rr. “...” nr. ..., me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj F.A., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 23 mars 2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, F.A., e paraqitur nga pala ankuese av. A.L. nga Prishtina, Rr. “...” nr. ..., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 03.03.2023 ka pranuar nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ankesën e palës ankuese av.A.L., lidhur me shqetësimet e shprehura lidhur me Aktvendimin E.nr.496/06, sipas Aktgjykimit C.nr.340/01 i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm i nxjerr nga gjyqtari F.A., i cili sipas pretendimeve të av.A.L. ka abuzuar qëllimshëm dhe ka mbajtur komunikim ex-parte me palët e rastit në procedurë, e cila ankesë nga Kryesuesi i KGJK-së, konform nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është transferuar tek autoriteti kompetent, kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj për trajtimin e saj.

Ankuesi av. A.L., në ankesën e ushtruar thekson faktin se që gjyqtari F.A., ka abuzuar qëllimshëm me personat e paautorizuar në këtë proces gjyqësor dhe komunikim ex-parte si me palë dhe me shkresa me persona të paautorizuar lidhur me lëndën E.nr.496/06 sipas aktgjykimit C.nr.340/01, po ashtu ka theksuar se gjyqtari nuk ua dorëzon, aktgjykimet, shkresat dhe aktvendimet palëve të autorizuar, kemi vërejte se ka bërë shkelje sa i përket përfaqësimit më autorizim- prokurë siç parasheh ligji për përfaqësim në organet shtetërore dhe gjykata. Këshilli Grevistë të Sindikatave legjitim IMT-Ndërmarrja për Prodhimin e Tubave të Çelikta, me seli në Ferizaj, Rr. “...” nr. ..., të cilën në këtë proces të autorizuar për 912 punëtor si kreditorë legjitim janë: R.M., F.M., A.S., Sh.B., Nj.A. Ankuesi ka theksuar se konsiderojnë se kemi mashtrim të Gjykatës me gjyqtarin F.A., nga palët të cilët kanë ndërhyrë në procesin gjyqësor pa autorizim: I.Q. – ish kryetar i sindikatës dhe B.F. – ish kryetar i bordit të fabrikës së tubave, të cilët gjyqtari i ka pranuar si të autorizuar me av. S.D..

Në ankesë i njëjti ka theksuar se gjyqtari i çështjes nuk na ka pranuar dhe nuk ka dorëzuar as shkresat e lëndës, të cilat me kërcënim nga këshilli grevist më datë 25 janar 2023 kanë pranuar aktvendimi dhe aktgjykimin, tutje duke shtuar se kanë bërë ankesë me shkrim në afatet ligjore tek gjyqtari i çështjes, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe në Gjykatën e Apelit, me arsyetimin se kërkesat e tyre nuk i janë shqyrtuar, por ka dorëzuar informacione – konkluzione, duke ikur përgjegjësisë që ka si gjyqtar, me neglizhencë të shkeljes së etikës profesionale dhe shkeljes së drejtës materiale dhe procedurale, duke pranuar palë të paautorizuar që kanë konflikt interesi me gjyqtarin duke shtuar se nuk bëjnë përmbarrim me persona të autorizuar por me persona të paautorizuar. Tutje ka shtuar se gjykata e anashkalon Këshillin Grevist të Sindikatës dhe pranon nga personat e paautorizuar të cilët nuk kanë qenë asnjë ditë në grevë dhe nuk i takojnë kësaj sindikate të cilën e kemi bërë grevën 713 ditë dhe nga këto greva janë larguar me dhunë. Duke kërkuar nga që pas inspektimit të rastit dhe pas vërtetimit të rastit të merren masa adekuate të largimit nga puna dhe të hapet procedurë penale për abuzim me detyra të punës dhe autorizimeve si gjyqtar për shkak të konfliktit të interesit. Për më tepër shih<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Parashtrësia kundër gjyqtarit F.A. nga av. A.L. dt. 28.02.2023.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje F.A., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se: sa i përket lëndës në fjalë, e njëjta me datë 10 shkurt 2023, është pranuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë së bashku me të gjitha shkresat e saj, për vendosjen sipas ankesave të debitorëve IMK - Ferizaj dhe AKP-së dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të ushtruara kundër Aktvendimit E.nr.469/05, i dt. 30 dhjetor 2022 dhe në mungesë të shkresave të lëndës gjykata në këtë deklaratë nuk mund të përdorë numra apo data të sakta sa i përket autorizimeve nga palët të cilët gjinden në shkresat e lëndës.

Duke shtuar se gjykata me datë 27 maj 2019, në kuadër të veprimeve përmbarimore në lëndën E.nr.469/05, të kreditorëve A.L.1. etj, kundër debitorit IMK - Ferizaj, e përfaqësuar nga AKP zyra regjionale në Gjiilan, ka mbajtur seancën dëgjimore publike, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i përfaqësuesit të kreditorëve, përfaqësuesit të Sindikatës së IMK-së në Ferizaj, si dhe përfaqësuesi nga AKP-ja – zyra regjionale në Gjiilan. I autorizuari i përfaqësuesit të sindikatës së IMK-së, av. S.D. nga Gjakova, me datë 29 korrik 2022, në këtë gjykatë ka dorëzuar propozimin, kërkesën me shkrim, me të cilën ka bërë zgjerimin e propozimit për përmbarim në kuptimin subjektiv, duke i propozuar gjykatës që të caktohet përmbarimi edhe ndaj debitorit të dytë. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të aktgjykimit të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës e evidentuar me numër: REF.nr. - AGJ 75/10, me numër të rastit KI.nr.08/09, të dt. 17 dhjetor 2010.

Gjithashtu, gjykata duke vendosur në kërkesën, propozimin e të autorizuarit të përfaqësuesit të sindikatës së IMK-së, me aktvendimin e dt. 10 tetor 2022, ka pranuar në tërësi propozimin e përmendur më lartë dhe e ka caktuar përmbarimin edhe ndaj debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas aktgjykimit të evidentuar si: REF.nr. AGJ 75/10, me numër të rastit KI.nr. 08/09, të dt. 17 dhjetor 2010, të lëshuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Gjyqtari A..., ka theksuar se kundër aktvendimit të datës 10 tetor 2022, brenda afatit ligjor debitorët kanë ushtruar prapësim, kurse gjykata me aktvendimin e datës 30 dhjetor 2022, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht e ka hedhë si të palejueshëm prapësimin e përfaqësuesit të debitorit NSH. IMK - Ferizaj, AKP zyra regjionale në Gjiilan, ndërsa ka vendosur të mbetet në fuqi aktvendimi i dt.10 tetor 2022.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit av. A.L., se në këtë proces gjyqësor është bërë komunikim ex-parte si me palë dhe me shkresa me personat e pa autorizuar dhe nuk i janë dorëzuar aktgjykimet, shkesat dhe aktvendimet palëve të autorizuar, Gjyqtari këto pretendime i konsideron në tërësi të pa bazuara, për faktin se gjykata i ka dërguar kopjet e veprimeve procedural dhe vendimeve të nxjerra në këtë lëndë përmbartimore e të cilat veprime janë ndërmarr në bazë të autorizimeve, gjegjësisht të lëshuara nga noteri kompetent, konsideron se nuk nënkupton aspak komunikim ex-parte me palët dhe po ashtu faktin se gjykata ka mbajtur seancë dëgjimore në rastin konkret po ashtu nuk nënkupton se kemi të bëjmë me komunikim ex-parte me ndonjërin nga palët, për arsye se komunikimi ex-parte nënkupton diçka tjetër nga ajo që pretendon av. A.L. dhe Instituti i komunikimit ex-parte është përcaktuar shumë qartë në rregullat dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Etikës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjyqtari i çështjes në deklaratë ka theksuar se në bazë të kërkesës së kreditorit Nj.A., me konkluzionin e datës 16 janar 2023, të njëjtit i ka dorëzuar kopjen e aktgjykimin C.nr.340/2001, të datës 11 janar 2002 dhe propozimin për përmbartim të kreditorëve. Po ashtu, me konkluzionin e datës 2 shkurt 2023, gjykata të autorizuarit të kreditorëve të përmendur më lartë av. A.L., nga Prishtina, bazuar në kërkesën e datës 1 shkurt 2023, ka njoftuar për veprimet përmbartimore të ndërmarra me lëndën E.nr.469/05, si dhe të njëjtin po ashtu e ka njoftuar se për shkak të ushtrimit të ankesave nga debitorët kundër aktvendimit të datës 30 dhjetor 2022 lënda në fjalë gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë për vendosje në ankesat e debitorëve. Përveç tjerash theksoi se gjykata me konkluzionin e cekur, avokatit A.L. i ka dërguar edhe aktvendimet për caktimin e përmbartimit edhe kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës të datës 10.10.2022 si dhe aktvendimin me të cilin është refuzuar gjegjësisht është hedhur si i pa lejueshëm prapësimi i debitorit NSH IMK - Ferizaj, e përfaqësuar nga AKP - zyra regjionale në Gjilan të datës 30.12.2022.

Gjithashtu tutje thekson se pretendimi i av. A.L., se: *“kemi mashtrim të gjykatës nga palët që kanë ndërhyrë në këtë proces gjyqësor pa autorizim, I.Q., ish Kryetar i Sindikatës dhe B.F., ish Kryetar i Bordit të Fabrikës së Tubave”*, gjyqtari F.A., konsideron se edhe ky pretendim është në tërësi i pa bazuar dhe i pa mbështetur në prova për arsye se në bazë të shkresave të lëndës, përkatësisht autorizimit LRP.nr. (numrin e të cilit për shkak të mungesës së shkresave të lëndës të cilat gjinden në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë) të lëshuar nga noteri kompetent, gjykata në pajtim

me dispozitat e nenit 107 paragrafi 1 të LPK-së ka dorëzuar shkresat, vendimet e ndërmarra nga gjykata palëve dhe të autorizuarve të palëve dhe fakti që gjykata ka vepruar konform dispozitave ligjore, gjegjësisht nuk nënkupton se është bërë ndonjë mashtrim në raport me palët.

Po ashtu gjyqtari ka theksuar se është me rëndësi të theksohet se bazuar në nenin 107 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thuhet *“Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtar”*, edhe gjyqtarët në punën e tyre, janë të pavarur dhe vendosin sipas provave dhe fakteve të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe sipas ligjeve në fuqi, dhe rrjedhimisht gjykata, përkatësisht si gjyqtari i çështjes në këtë rast por edhe në të gjitha rastet tjera që ngarkohet më lëndë, ka vendosur në bazë të nenit 17 të LPP-së, lidhur me nenin 8.1 të LPK-së ku shprehimisht është theksuar : *“Se cilat fakte do t’i konsideroj të provuara e cilat jo, vendos vet gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”*, duke ritheksuar në fund se të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në lëndën E.nr.469/05, janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës nga nenit 107 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe Ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës, si dhe me të gjitha ligjet tjera në fuqi, dhe deklaratës së tij me shkrim gjyqtari i ka bashkangjitur: procesverbalin se seancës dëgjimore në çështjen E.nr.496/05 të përpiluar me datë 27.05.2019, Aktvendimin E.nr.496/05 të datës 10.10.2022, Aktvendimin E.nr.469/05 të datës 30.12.2022 mbi refuzimin e prapësimit të debitorëve Qeveria e Kosovës, konkluzionin E.nr.469/05 dt.16.01.2023, konkluzionin E.nr.496/05 të datës 02.02.2023 si dhe konkluzionin E.nr.469/05 të datë14.02.2023.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit dhe shkresave të bashkangjitura në deklaratë nga gjyqtari<sup>2</sup>, si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese dhe ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari F.A.

---

<sup>2</sup> Komplet lënda E.nr.469/05 sipas deklarimit të gjyqtarit me datë 10.02.2023 është dërguar në Gjykatën e Apelit të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesat e debitorëve IMK Ferizaj – AKP Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Gjykatës vlerëson se pretendimet e palës ankuese në rastin konkret se ka abuzim të qëllimshëm me personat e paaautorizuar dhe komunikim ex-parte si me palë ashtu edhe me shkresa nga ana e gjyqtarit F.A., nuk qëndrojnë. Nuk mund të konkludohet se mbajtja e seancës dëgjimore përmes procesverbalit siç është ajo e datës 27.05.2019, apo dorëzimit të shkresave- vendimeve gjyqësore të jetë komunikim ex-parte nga ana e gjyqtarit. Pretendimi i palës ankuese se gjyqtari është përfshirë në komunikime me ex-parte me ndonjërin nga palët në procedurë duhet të jetë i mbështetur në ndonjë provë, gjë që në këtë rast nuk është siguruar asnjë provë për ta dëshmuar se në ndonjë mënyrë gjyqtari është përfshirë në komunikime ex-parte apo qëllimshëm të këtë neglizhuar apo abuzuar me palët në procedurë, pasi që Autoriteti Kompetent vlerëson se trajtimi i kësaj lënde, përcjellja e shkresave, vendimeve dhe aktgjykimeve tek personat e autorizuar, po ashtu edhe veprimet procedurale të ndërmarra në lëndën E.nr.469/05, nga ana e gjyqtarit janë veprime që janë ndërmarr brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive si gjyqtar në pajtim dispozitat ligjore të Ligin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Procedurën Përmbartimore ashtu siç i ka deklaruar gjyqtari në deklaratën e tij me shkrim.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore ndaj gjyqtari F.A., andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**ADGJTHFR.3/23**

**23 mars 2023**

**Mustaf TAHIRI**

---

**Kryetar i Gjykatës**

### **Iu dërgohet:**

Av. A.L. nga Prishtina, Rr. “...” nr. ... - Parashtrues i ankesës

F.A. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës